




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/37
Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Koncept Dokumenti për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**KONCEPT DOKUMENT PËR AGJENCINË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE
VERIFIKIM TE PRONËS.**

Prishtinë, Dhjetor 2017

1. Hyrja

Pas Raportit me Rekomandime të Avokatit të Popullit me nr. reference Rasti Nr. 551/2017, është shfaqur nevoja e adresimit të të gjeturave nga ana e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP).

Poashtu duke marrë parasysh prioritetet e qeverisë së Republikës së Kosovës për ofrimin e vizionit strategjik për të drejta pronësore, me qëllim të përkufizimit të qartë me ligj të të drejtave pronësore, përmes së cilës qytetarëve u ofrohet njohje juridike të të drejtave pronësore, kthimin e të zhvendosurve dhe duke u bazuar në mbrojtjen e të drejtës pronësore e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është më se e nevojshme të adresohen të gjeturat e Avokatit të Popullit lidhur me ligjin për AKKVP-në dhe plotësim ndryshimi i ligjit bazuar në sfidat cilat janë hasur gjatë zbatimit të ligjit për AKKVP-në.

Qeveria e konsideron me prioritet adresimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit sa i përket këtyre çështjeve. Lidhur me shqetësimet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, nenet e theksuara në këto rekomandime paraqesin shkelje të së drejtës së pronës, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe instrumenteve evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Adresimi i këtyre çështjeve në këtë aspekt synon të jetë në përputhshmëri të plotë me instrumentet evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat përbëjnë interes të përhershëm për Qeverinë. Në anën tjetër, ndryshimet si pasojë e sfidave tjera për zbatim të legjislacionit në fuqi kanë rëndësi dhe ndikim në fushën e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe atë pronësore në veçanti dhe si të tilla do të adresohen.

Me plotësim ndryshim të ligjit, është e domosdoshme dhe prioritet të parashihet edhe formalizimin e të drejtave të pronës së qytetarëve të Kosovës, për ti ofruar njohje juridike të të drejtave jo formale, përmes trajtimit të informalitetit, duke i dhënë kompetenca dhe detyra shtesë AKKVP-së, ashtu siç parashihet në Strategjinë Kombëtare për të Drejta Pronësore dhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj.

2. Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit

Rekomandimet nga Avokati i Popullit

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit NR. 05/L-10 për AKKVP-në në nëntor të vitit 2016, Avokati i Popullit ka adresuar shqetësimin lidhur me përfundimin e administrimit të pronave dhe kufizimet në kryerjen e dëbimeve nga AKKVP.

Me qëllim të realizimit të të drejtave pronësore, përkatësisht qasjes në pronë, është parashikuar administrimi i pronave nga AKKVP të cilat si subjekt i administrimit janë trashëguar nga ish Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore dhe Agjencia Kosovare e Pronës.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të sipërpërmendur për AKKVP-në, administrimi i pronave është paraparë të përfundojë në afat prej 18 muajsh pas hyrjes në fuqi të ligjit. Gjithashtu, me këtë ligj është hequr kompetenca për AKKVP-në për të kryer dëbime pas dy uzurpimeve të së njëjtës

pronë pas 72 orëve. Ky ligj parasheh se për çdo ri uzurpim pasues të pronës se njëjtë, do të zbatohen rregullat e procedurave të përgjithshme të përmbarimit bazuar në të njëjtin vendim/aktgjykim dhe urdhër dëbim si dokumente përmbaruese.

Përfundimi i administrimit të pronave të administruara nga AKKVP si dhe heqja e kompetencës për të kryer dëbime pas dy uzurpimeve, paraqet privim nga të drejtat e njeriut, mbrojtjes të së drejtës dhe qasjes në pronë, në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumenteve evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në terma praktik kjo nënkupton: Mos administrimi i pronave dhe mos kryerja e dëbimeve pas dy uzurpimeve nga AKKVP, paraqet privim nga të drejtat e njeriut, mbrojtja e së drejtës dhe qasjes në pronë, uzurpim të paligjshëm potencial, shkatërrim potencial të pronës së paluajtshme, potencialisht privim nga të hyrat e qirasë të cilat ashtu siç u cek më lartë janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumenteve evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Me heqjen e këtyre kompetencave nga ligji i lartë përmendur, janë afektuar direkt të drejtat pronësore dhe pronat e Personave të Zhvendosur në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ndryshimet si rezultat i sfidave në zbatimin e ligjit

Përveç çështjeve të ngritura më lartë, janë paraqitur edhe nevoja tjera për adresimin e problemeve pas sfidave që janë paraqitur në zbatimin e ligjit, sikurse shtimin e detyrave për organet e AKKVP-së dhe në anën tjetër qartësimin e dispozitave ligjore të caktuara dhe nxjerrjen e akteve nënligjore.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit për AKKVP-në, është e nevojshme të plotësohet ligji për të mundësuar zbatimin e plotë e skemës së kompensimit për zbatimin e vendimeve të ish Komisionit për Kërkesa Pronësore Banësore (KKPB), skemë kjo e projektuar për kompensimin e pronarëve të cilët kishin humbur të drejtat pronësore si pasojë e diskriminimit. Zbatimi i 143 vendimeve të tilla është e paparaparë edhe në Strategjinë Kombëtare për të Drejta Pronësore. Në anën tjetër, zbatimi i kësaj skeme për të cilën është duke u hartuar Udhëzimi Administrativ, parasheh detyra shtesë për Komisionin për Kërkesa Pronësore të AKKVP-së. Në këtë aspekt Komisionit për Kërkesa Pronësore me këtë ligj nuk i janë përcaktuar detyrat për lëshimin e Vendimit me të cilin konfirmohet përmbyllja e obligimit në zbatim të vendimit të lëshuar nga KKPB.

Poashtu problematikë tjetër është paraqitur edhe zbatimi efikas i mjeteve juridike të parapara në nenin 18 të ligjit për AKKVP-në. Andaj, është i nevojshëm qartësimi dhe forcimi i bazës ligjore lidhur me mjetet juridike të ankandit, konfiskimit dhe shkatërrimit të objekteve të paligjshme. Ndërsa, lidhur me mjetin juridik të ankandit dhe konfiskimit dhe në mungesë eventuale të kornizës ligjore apo ndërthurjes me kompetenca të organeve tjera publike në legjislacionin në fuqi, mungon dispozita e qartë për zbatimin e këtyre dy mjeteve juridike nga AKKVP.

Sa i përket heqjes së afatit për nxjerrje të akteve nënligjore i paraparë në nenin 30 të ligjit, është paraqitur sfidë respektimi i këtij afati. Në këtë aspekt plotësim ndryshimi i ligjit për

heqjen e kufizimit kohorë për të nxjerrë ligjin sekondar, është më se e nevojshme me qëllim të lehtësimit të zbatimit të ligjit dhe praktikës së mirë.

Gjithashtu gjatë zbatimit të ligjit është vërejtur se ka paqartësi në shprehjet e përdorura si: “dallim- zbrazëti dhe mospërputhje-mospajtim” të cilat ndikojnë drejtë për drejtë prolongimin e proceseve të zgjidhjes së lëndëve.

Sfidat e paraqitura në Strategjinë Kombëtare për të Drejta Pronësore

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për të Drejta Pronësore dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj, parashihet adresimi i informalitetit për njohjen juridike të të drejtave formale, e cila nuk është e rregulluar me ligjin në fuqi. Kapacitetet institucionale të AKKVP-në, procedurat efektive dhe të thjeshta dhe praktikave më të mira, do të mund të zbatoheshin edhe në procedurat tjera administrative për zgjidhjen më efektive të shkakut kryesor të informalitetit. Sipas dokumenteve të lartë përmendura është paraparë që si alternativë të shqyrtohet mundësia që këtë funksion ta kryej AKKVP-ja si detyrë shtesë për shkak të përvojës dhe procedurave të instaluar në këtë institucion.

Trajtimi i informalitetit nga AKKVP do të ishte në interes jo vetëm të institucioneve të Kosovës por edhe të qytetarëve për shkak të përvojës, praktikave më të mira, procedurave efektive dhe të thjeshta që ka instaluar AKKVP lidhur me trajtimin e çështjeve pronësore që nga paslufta e deri tani. Procedurat e qarta, transparente, efektive, mënyra e trajtimit të lëndëve dhe përvoja me palët, do të mundësonin që ky funksion të kryhet nga AKKVP pa pasur nevojë të krijohet ndonjë institucion tjetër, i cili do të duhej të merrej që nga fillimi me këto procedura. Për më tepër, krijimi i ndonjë institucioni tjetër, përveç që do të vononte shumë trajtimin e kësaj kategorie, e cila edhe ashtu është prolonguar shumë, do të kishte edhe kosto tepër të lartë për buxhetin e Kosovës në aspektin financiar dhe në të njëjtën kohë do të vazhdon edhe për një kohë të gjatë pasiguria dhe pa qartësi e të drejtave pronësore e kësaj kategorie.

Krijimi potencial i ndonjë institucioni tjetër veç AKKVP-së do të ishte ngarkesë e pa nevojshme buxhetore dhe burokratike për institucionet e Kosovës për shkak të investimeve të mëdha dhe kohës së gjatë për themelimin e tij, trajnimin e stafit, ngritjen e kapaciteteve si njerëzore ashtu edhe atyre teknike, krijimin e përvojave të mira të cilat marrin shumë kohë dhe mund, dhe mbi të gjitha opsioni i themelimit të ndonjë institucioni tjetër nuk do të garantonte sukses, për shkak të mos përvojës së mjaftueshme në trajtimin e kontesteve dhe problemeve pronësore.

Arsye tjetër shtesë dhe jo më pak e rëndësishme për dhënien e kompetencave apo mandatimin e AKKVP-së për trajtimin e informalitetit do të ishte edhe ndërlidhja e kësaj kategorie të çështjeve pronësore direkt me mandati aktual të cilin e ushtron AKKVP, sic është krahasimi dhe verifikimi i dokumenteve kadastrale. Në rast se trajtimi i informalitetit do të bëhej nga AKKVP, ku mendohet se mbi 30% e pronave në Kosovë i takojnë kësaj kategorie, këto lëndë të trajtuara nga AKKVP, drejtpërdrejtë do të lehtësonin në zvogëlimin e numrit të lëndëve për krahasim dhe verifikim të lëndëve, të cilat AKKVP sipas ligjit në fuqi edhe ashtu do të duhej ti trajtonte. Me fjalë të tjera AKKVP do të mund të reduktonte në masë të madhe punën e

dyfishtë duke bërë njëkohësisht trajtimin e informalitetit dhe verifikimin dhe krahasimin në të njëjtën kohë. Në këtë mënyrë do të mund të kurseheshin shpenzimet shtesë të buxhetit të Kosovës dhe njëkohësisht do të mund të kryhej trajtimi i informalitetit si dhe reduktimi i lëndëve për krahasim dhe verifikim të tyre. Në të kundërtën të gjitha lëndët e trajtuar nga ndonjë institucion tjetër vec AKKVP-së do të mund të ishin subjekt i krahasimit dhe verifikimit nga AKKVP.

Politika Aktuale

1. Në pajtim me nenit 21, paragrafin 7 dhe 8 të ligjit për AKKVP, Agjencia do të vazhdojë me administrimin e pronave dhe zbatimin e skemës së qirasë më së largu deri 18 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Brenda këtij afati, AKKVP është e obliguar t'i informoj të gjithë bartësit e të drejtës pronësore për afatin e fundit të administrimit dhe afatin e ushtrimit të kërkesës për ri posedim apo kërkesës për mbyllje. AKKVP aktualisht ka rreth 12647 prona nën administrim dhe rreth 4406 prona në skemën e qirasë ku prej tyre 1010 janë të lëshuara me qira. Megjithatë, procedurat e nevojshme për ndërprejen e administrimit nuk kanë filluar të zbatohen për shkak të vonesës në miratimin e Udhëzimit Administrativ (Qrk) nr.07/2017 për Procedurat, Kushtet dhe Kriteret rreth Përfundimit të Administrimit të Pronave nën Administrimin dhe atyre të përfshira në Skemën e Qirasë.
2. Sipas nenit 18, paragrafit 1 i ligjit për AKKVP, njëra nga mjetet juridike për zbatimin e vendimeve është dëbimi, mjet ky i cili zbatohet pas kërkesës nga bartësi i të drejtës pronësore në rastet e kërkesës për riposedim të pronës. AKKVP, sipas legjislacionit në fuqi, ex officio e aplikon dëbimin në rastet kur prona është nën administrimin e AKKVP-së ose në Skemën e Qirasë dhe kur e njëjta uzurpohet. Në të gjitha rastet e dëbimeve me kërkesë për riposedim të pronës nga bartësi i të drejtës pronësore, sipas nenit 19 të ligjit, nëse prona ri uzurpohet brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas kohës së përmbarimit të urdhëresës për dëbim dhe pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës për ri uzurpimin e pronës, AKKVP do ta ri përmbaroj atë edhe një herë përmes ri dëbimit të uzurpuesit, bazuar në urdhëresën e re të lëshuar. Sipas paragrafit 7 të të njëjtit nen, për çdo ri uzurpim pasues të pronës se njëjtë, AKKVP nuk ka kompetencë të mëtejme.
3. Sa i përket zbatimit të vendimeve të KKPB-së lidhur me skemën e kompensimeve, sipas nenit 22, AKKVP nuk e kishte zbatuar këtë skemë në mungesë të mjeteve financiare. AKKVP gjithashtu është në proces të hartimit të një Udhëzimi Administrativ për këtë çështje. AKKVP-së i janë ndarë një pjesë e mjeteve financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe për zbatim të suksesshëm të saj është paraqitur nevoja e plotësimit ndryshimit të ligjit për AKKVP-në.
4. Mjetet juridike të ankandit, konfiskimit dhe të shkatërrimit të objekteve të paligjshme nuk janë aplikuar deri më tani në mungesë të bazës ligjore për nxjerrjen e legjislacionit sekondar.

5. Mos adresimi dhe mos trajtimi i çështjeve rreth informalitetit, përveç që paraqet sfidë dhe angazhim për insitucionet e Kosovës, ndikon negativisht drejtpërdrejtë në të drejtat e qytetarëve të Kosovës dhe në anën tjetër ndikon negativisht në sigurinë juridike të qytetarëve duke krijuar pa qartësi për të ardhmen e fatin e pronave të tyre.

Kryerja e këtij funksioni nga AKKVP për trajtimin e informalitetit duke u bazuar në arsyet si në vijim: përvoja në zgjidhjen kontesteve në fushën e të drejtave pronësore, praktikat më të mira, transparente, kapacitetet njerëzore, infrastruktura teknike dhe teknologjike, sistemi dhe mënyra e përpunimit të lëndëve, si dhe procedurat efikase dhe të thjeshta që ka të instaluar AKKVP, padyshim do të kishin ndikim pozitiv në zgjidhjen e shpejtë dhe në mënyrë efikase të këtyre lëndëve, në fushën e të drejtave pronësore të adresuara nga Strategjia Kombëtare për të Drejta Pronësore, si dhe pa dyshim se do të kishte ndikim pozitiv në zvogëlimin e barrës financiare të buxhetit të Kosovës.

Andaj, duke pasur parasysh se nuk është e nevojshme të bëhet punë e dyfishtë nga dy institucione të ndryshme, me kompetenca dhe mandat të ndryshëm, për trajtimin e lëndëve të tilla, ku për pasojë do të kishte kosto dhe barrë financiare për buxhetin e Kosovës, procedurë e dyfishtë, zvarritje të procesit nga dy institucione për të njëjtën punë, burokraci e panevojshme dhe potencialisht ngecje në adresimin dhe trajtimin e zgjidhjes së problemeve të kësaj kategorie, është më se e nevojshme të shqyrtohet opsioni për plotësim ndryshimin e ligjit për ti dhënë kompetenca AKKVP-së për trajtimin e informalitetit.

Ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me këto çështje.

Ligjet dhe aktet e mëposhtme nën ligjore ndërlidhen drejtë për së drejti me çështjet e lartë përmendura:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 përmes të cilit garantohen të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, ku bën pjesë edhe e drejta e pronës në kuadër të drejtave të njeriut. Me nenin 46, drejtpërdrejtë është e garantuar e drejta pronës. Poashtu edhe shfrytëzimi i pronës është i garantuar dhe mbron privimin arbitrar nga e drejta e pronës. Kurse me nenin 55 janë të mbrojtura liritë dhe të drejtat e njeriut, dhe si të tilla mund të kufizohen vetëm me ligj, përfshirë këtu edhe të drejtën e pronës, si pjesë e pandashme e të drejtave themelore të njeriut. ;
- Ligji për AKKVP-në nr. 05/L-10, me të cilin përcaktohet organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, i cili ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale si dhe krahasimin e zgjidhjen e dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare. Udhëzimi Administrativ (Qrk) Nr.07/2017 për Procedurat, Kushtet dhe Kriteret rreth Përfundimit të Administrimit të Pronave nën Administrimin dhe atyre të përfshira në Skemën e Qirasë të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, me cilën përcaktohen kushtet dhe kriteret rreth përfundimit të administrimit të pronave nën

administrim dhe atyre të përfshira në skemën e qirasë të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, të drejtat dhe obligimet e Agjencisë dhe palëve në lidhje me pronat nën administrim si dhe përfundimin e administrimit të pronave nën administrim nga Agjencia.

- Rregullore (Qrk) Nr.10/2017 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Organizimin e Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim Dhe Verifikim të Pronës, organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë; e cila përcakton detyrat, përgjegjësitë, organizimin e Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, procedurat e krahasimit dhe verifikimit të dokumenteve dhe zgjidhjes së rasteve, vazhdimin i zgjidhjes së kërkesave të parashtruara sipas procedurave në Agjencinë Kosovare të Pronës, të drejtat e palëve në procedure, nxjerrjen e vendimeve, zbatimimi i vendimeve përmes mjeteve juridike të parapara me ligj, bashkëpunimin me institucionet tjera dhe kriteret e zgjedhjes së Drejtorit/es dhe Zëvendësdrejtorit/es.
- Rregullore (Qrk) nr. 08/2017 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Procedurat e Komisioneve të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, përmes së cilës përcaktohen detyrat, përgjegjësitë, procedurat e punës, parimet e përgjithshme, organizimi, mbajtja e seancave dhe mënyra e marrjes së vendimeve të Komisioneve të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të pronës.

Shpenzimet Aktuale;

Tabela

Kategoria e Shpenzimeve	Shpenzimet Faktike në vitin paraprak (2016)	Buxheti për këtë vit (2017)	Korniza Afat mesme e Shpenzimeve (KASH) për vitin e ardhshëm
Buxheti i Agjencisë	1,742,697	2,193,307	6,057,155 (këtu përfshihet skema e kompensimit dhe shpenzimet kapitale)
Buxhetet tjera	0	0	0
Financimi nga Donatorët	140,402	0	0
Shpenzimet e Drejtë për drejta nga MF	1,711,256	1,589,063	6,057,155

3. Synimet dhe objektivat

Synimi:

Përmirësimi i kornizës ligjore me synim të zbatimit të standardeve dhe normave evropiane dhe ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të drejtës pronësore për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Objektivat

- Hartimi i legjislacionit sipas standardeve evropiane dhe ndërkombëtare që ndërlidhen me të drejtat pronësore;
- Zbatimi më i lehtë dhe efikas i ligjit përmes ri posedimit dhe administrimit të pronës;
- Plotësim ndryshimi i ligjit për përcaktimin e detyrave shtesë për lëshimin e Vendimit me të cilin konfirmohet përmbushja e obligimit në zbatim të vendimit të lëshuar nga KKP;
- Plotësim ndryshimi i ligjit për adresimin e informalitetit, sipas Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj;
- Plotësim ndryshimi i ligjit për zbatimin efikas të ligjit për nxjerrjen e akteve nën ligjore.

4. Opsionet

Opsioni 1: Opsioni i status quos

Sipas këtij opsioni, nuk duhet marr ndonjë veprim në plotësimin apo ndryshimin e ligjit dhe akteve nënligjorë ekzistuese.

Kjo gjendje nuk lejon realizim e plotë të të drejtave të njeriut sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, standardeve evropiane dhe atyre ndërkombëtare. Me vazhdimin e zbatimit të ligjit aktual vazhdon shkelja e të drejtave të njeriut dhe atyre pronësore siç është konstatuar në raportin e Avokatit të Popullit.

Opsioni 2: Plotësim ndryshimi i politikës ekzistuese

Plotësim ndryshimi i ligjit lidhur me çështjet e ngritura ndikon drejtpërsëdrejti në zbatimin e plotë dhe efikas të ligjit në njërën anë dhe realizimin e të drejtave pronësore në anën tjetër.

Ky opsion nënkupton nxjerrjen e ligjit për plotësim ndryshim të ligjit ekzistues, mbi bazën e të cilit do të nxirreshin akte tjera nënligjore dhe të cilat së bashku do të mundësonin realizim të të drejtave të njeriut sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, standardeve evropiane dhe atyre ndërkombëtare.

Neni 18 i ligjit aktual për AKKVP-në, duhet të ndryshohet për të qartësuar zbatimin e mjeteve juridike të ankandit dhe konfiskimit. Poashtu nevojitet të shtohet një paragraf i ri i cili obligon hartimin e legjislacionin sekondar në lidhje me zbatimin e këtyre mjeteve juridike.

Poashtu neni 19 i ligjit aktual për AKKVP-në, do të ndryshohet për të mundësuar dëbimin në pronë, nëse prona ri uzurpohet dhe pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës për ri uzurpimin e pronës. AKKVP do ta ri përmbaroj atë përmes ri dëbimit të uzurpuesit, bazuar në urdhëresën e re të lëshuar. Gjithashtu nevojitet të shtohet një paragraf i ri i cili obligon hartimin e legjislacionin sekondar në lidhje me zbatimin e këtyre mjeteve juridike.

Neni 21, paragrafi 7 dhe 8 i ligjit aktual për AKKVP-në, do të ndryshohet për të mundësuar vazhdimi i administrimit edhe për një periudhë të arsyeshme derisa AKKVP ti rekomandoj Qeverisë së Republikës së Kosovës për nisjen e proceduarve për përfundimin e administrimit,

si dhe nxjerrjen e legjislacionit sekondar për procedurat dhe rregullat për vazhdimin administrimit të pronave nga AKKVP.

Neni 22 i ligjit aktual për AKKVP-në, do të ndryshohet lidhur me zbatimin e vendimeve të KKPB-së për skemën e kompensimeve. Në këtë aspekt Komisionit për Kërkesa Pronësore me këtë ligj duhet ti përcaktohen detyrat shtesë për lëshimin e Vendimit me të cilin konfirmohet përmbushja e obligimit në zbatim të vendimit të lëshuar nga KKPB.

Neni 30 i ligjit për AKKVP-në duhet të ndryshohet poashtu për shkak të sfidave të paraqitura gjatë zbatimit të tij.

Me nxjerrjen e plotësim ndryshim të ligjit duhet të qartësohet edhe përkufizimi i termave “dallim- zbrazëti dhe mospërputhje-mospajtim” të cilat kanë shkaktuar pengesa në zbatim të ligjit.

Gjithashtu me nxjerrjen e plotësim ndryshim të ligjit për AKKVP-në, do të rregullohet edhe çështja e informalitetit për njohjen juridike të të drejtave formale.

Opsioni 3

Bazuar në rekomandimet e Avokatit të Popullit në lidhje me politikën ekzistuese për pezullimin e udhëzimit administrativ, mund të nxirret një udhëzim administrativ i ri i cili do të rregullonte procesin e njoftimit të pronarëve për përfundimin e administrimit.

Mirëpo edhe ky opsion nuk ofron zgjidhje të qëndrueshme për çështjet e ngritura nga Avokati i Popullit, pasi që dispozitat e ligjit nuk ndryshojnë me udhëzimin administrativ të ri.

Me fjalë të tjera ky opsion nuk zgjidh çështjet e ngritura për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe atyre pronësore.

5. Përmbledhja e opsioneve

Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit.	Status Quo	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për AKKVP	Ndryshimi i qasjes ekzistuese
Segmenti i popullsisë / sektori / rajoni i shënjestruar.	Qytetarët e Kosovës/territori i Republikës së Kosovës	Qytetarët e Kosovës/territori i Republikës së Kosovës	Qytetarët e Kosovës/territori i Republikës së Kosovës
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët.	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Administrimit ose zbatimi i programit ose shërbimit	AKKVP	AKKVP	AKKVP
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet.	Nuk ndryshon asgjë	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për AKKVP	Ndryshimi dhe plotësimi i udhëzimit administrativ Nr. 07/2017 për Procedurat, kushtet dhe kriteret rreth përfundimit të administrimit të pronave nën administrim dhe atyre të përfshira në skemën e qirasë së AKKVP.
Stimulimet ose mos stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat.	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Fushatat e edukimit dhe komunikimit.	Fushatë vetëdijësuese për palët e afektuara	Fushatë vetëdijësuese për palët e afektuara	Fushatë vetëdijësuese për palët e afektuara
Udhëzimet dhe kodet.	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni.	Në fuqi	Maj 2018	Shkurt 2018

6. Analiza e opsioneve

Përfitimet e opsionit 1 (status quo). Sipas këtij opsioni do të përfundonte administrimi i pronave nën administrimin e AKKVP-së, përmes të cilës AKKVP do ta përmbyllte një pjesë të mandatit të saj.

Përfitimet e opsionit 2

Përmes këtij opsioni do të bëhet siguria juridike e administrimit të pronave, realizimi i të drejtave, përmbushja e standardeve ndërkombëtare dhe lidhur me të drejtën pronësore të garantuara, mbrojtja nga uzurpimet e mundshme dhe keqpërdorimi i pronave pa titullar, krijimi i ambientit për kthim të personave të zhvendosur.

Poashtu përmes këtij opsioni do të adresohet edhe zgjidhja e informalitetit apo trajtimi i kësaj kategori të pronave, e cila krijon u ofron qytetarëve siguri juridike.

Përfitimet e opsionit 3

Me këtë opsion do të mundësohet për një afat të shkurtë kohorë të bëhet njoftimi i palëve lidhur me përfundimin e administrimit të pronave.

Pasojat negative

Opsioni 1 (status quo)

Nga ky opsjon ndikohen direkt palët të cilat kane vendosur pronën nën administrimin e AKKVP-së, si dhe palët të cilëve do të mund të uzurpohej prona në mënyrë të pa ligjshme. Kjo çështje mund ta ngadalësojë integrimin e Kosovës në proceset integruese evropiane.

Opsioni 2

Përmes këtij opsioni do të cenohej siguria e juridike e palëve për të ushtruar të drejtën e tyre themelore pronësore, si dhe dëmtimin e mundshëm të pronave të cilat do të mbeteshin pa përkujdesje institucionale. Mos adresimi i informalitetit dhe zvarritja apo prolongimi i tij, do afektonte negativisht të drejtat pronësore të qytetarëve të Kosovës, do të krijohej pasiguri juridike për të drejtat pronësore, ardhmëri jo e sigurtë për fatin e të drejtave pronësore për këtë kategori, si dhe do të mund të kishte potencialisht ndikim negativ në tregun e pronave.

Opsioni 3

Nga ky opsjon do të afektoheshin institucionet, të gjitha palët të cilat kanë hyrë në marrëveshje mbi qiranë me AKKVP-në dhe poashtu edhe pronarët e pronave.

Kosto

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	(Euro)			
	Viti aktual 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Opsioni 1 (asnjë ndryshim)	2,193,307	2,191,951	2,160,595	2,144,239
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	--	(1,356)	(31,356)	(16,356)
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	--	(35,000)	(35,000)	(35,000)
Financimi i pritur nga donatorët	-	0	0	0
Opsioni 2 (ndryshim i politikës ekzistuese)	2,193,307	2,199,307	2,200,807	2,202,657
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	-	3,000	1,500	1,850
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	35,000	35,000	35,000	35,000
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0
Opsioni 3 (ndryshim i politikës ekzistuese)	2,193,307	2,204,951	2,160,595	2,144,239
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve		11,644	(32,712)	(16,356)
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave		(35,000)	(35,000)	(35,000)
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0

7. Konsultimi

Pas pranimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të njëjtin e kemi vënë në diskutim dhe gjatë kësaj faze jemi konsultuar me AKKVP-në, Policinë e Kosovës, OSBE-në dhe PSBE-në.

Konsultimet do të realizojmë konform Rregullores 09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Udhëzuesit për Procesin e Konsultimeve Publike ku palëve të lartë cekura ua kemi dërguar direkt draftin fillestar të koncept dokumentit.

Nga këto konsulta është arritur përfundimi se ndryshimet e lartpërmendura në ligjin për AKKVP-në janë më se të domosdoshme.

8. Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1: (opsioni status quo), do të nënkuptonte vazhdimin edhe për një periudhë kohore të një gjendjeje të tillë, e që nuk është gjendje e përshtatshme për shkak të sfidave në zbatimin e ligjit dhe shkeljeve të paraqitura në Raportin e Avokatit të Popullit. Ky opsion drejtpërdrejtë do të ndikonte në të drejtat e personave të zhvendosur, përfshirë të drejtat pronësore.

Opsioni 2: (Plotësim ndryshimi i ligjit), ky opsion mundëson zbatimin e plotë dhe efikas të ligjit lidhur me të drejtat pronësore si dhe adreson dhe zgjidh shqetësimet e ngritura nga Avokati i Popullit duke i realizuar kështu të drejtat pronësore në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumenteve të tjera juridike evropiane dhe ndërkombëtare. Dhënia e kompetencave për trajtimin e informalitetit nga AKKVP do t'u mundësonte institucioneve të Kosovës dhe qytetarëve të saj zgjidhje më të shpejtë të problemit të informalitetit si dhe do të reduktonte në masë të madhe periudhën kohore për zgjidhjen e këtyre problemeve pronësore. Në të njëjtën kohë të lehtësonte barrën buxhetore të Kosovës, duke shmangur kështu krijimin e institucioneve tjera të pa nevojshme për zgjidhjen e këtij problemi, si dhe shfrytëzimin e kapaciteteve aktuale të AKKVP-së për zgjidhje të shpejtë dhe efikase të kësaj kategorie të pronave.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese

Bazuar në rekomandimet e Avokatit të Popullit në lidhje me politikën ekzistuese për pezullimin e udhëzimit administrativ, mund të nxirret një udhëzim administrativ i ri i cili do të rregullonte procesin e njoftimit të pronarëve për përfundimin e administrimit.

Mirëpo edhe ky opsion nuk ofron zgjidhje të qëndrueshme për çështjet e ngritura nga Avokati i Popullit, pasi që dispozitat e ligjit nuk ndryshojnë me udhëzimin administrativ të ri.

Me fjalë të tjera ky opsion nuk zgjidh çështjet e ngritura për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe atyre pronësore.

9. Rekomandimi

Sipas krahasimit të opsioneve, mbështetur në mundësitë që jep secili opsion, për të qenë sa më koherent dhe me qëllim të krijimit të një baze sa më të mire ligjore, komisioni në fjalë rekomandon **Opsionin 2 (Plotësim/Ndryshim të Ligjit)**.

10. Komunikimi

Komunikimi, koordinimi dhe shpërndarja e informatave në mes të gjithë akterëve të përfshirë është çështje kyçe.

Me qëllim të njoftimit sa më të mirë dhe transparent të palëve të interesit dhe publikut më të gjerë me zhvillimet e reja, për risitë dhe përparësitë që plotësim/ndryshimi i ligjit do të sjellë , do të përgatitet një Plan i Veprimit nga Qeveria dhe AKKVP, ku së bashku me personat përgjegjës për hartimin e draftit fillestar të plotësim/ndryshim të ligjit për AKKVP-në do ti informojë të gjithë akterët dhe palët e interesit që prekë kjo fushë.